



Republika e Kosovës
Republika Kosovo–Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Sesioni Vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 83/2012
Prishtinë, më 14.11.2012, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ZHVILLIM EKONOMIK, INFRASTRUKTURË,
TREGTI DHE INDUSTRI

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti – kryetar, Sala Berisha–Shala, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Visar Ymeri dhe Myzejene Selmani

Munguan: Teuta Sahatqija, Fikrim Damka, Berat Buzhala, Ramiz Kelmendi dhe Biserka Kostiq.

Pjesëmarrësi i ftuar: z.Besim Beqaj - Ministër i zhvillimit ekonomik.

Pjesëmarrës të tjerë : Frymëzim Isufaj, Bedri Dragusha dhe Luan Morina – MTI, Burim Ejupi-INDEP; Nevahir Haziri - KDI; Leon Përlaska, Qëndrim Arifaj dhe Durim Osmani – OJQ “Koha të Veprosht”.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e kryesoi, Zenun Pajaziti - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Raportim i ministrit të zhvillimit ekonomik, për nivelin e zbatimit të Ligjit për efikasitetin e energjisë;
3. Te ndryshme;

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Raportim i ministrit të zhvillimit ekonomik, për nivelin e zbatimit të Ligjit për eficiencën e energjisë

Kryetari – Tha se Komisioni e ka paraparë në Planin e Punës, për vitin 2012, ta bëjë monitorimin e Ligjit për eficiencën e energjisë, dhe, grupi i punës e ka hartuar planin e punës, ku është paraparë që për nivelin e zbatimit të Ligjit për eficiencën e energjisë, të raportojë ministri i zhvillimit ekonomik z.Besim Beqaj, të cilit ia dha fjalën për të paraqitur një ekspozë nga ana politike, lidhur me aktivitetet e MZHE-së, që kanë të bëjnë me Ligjin për eficiencën e energjisë.

Besim Beqaj, ministër i zhvillimit ekonomik - I njoftoi deputetët e Komisionit, lidhur me nivelin e zbatimit të Ligjit për eficiencën e energjisë dhe masat e marra për implementimin e tij. Kosova është model për rajonin sa i përket legjislativit të fushës së energjisë, tha në fillim të paraqitjes së tij, ministri Beqaj. Ai, po ashtu nënvizoi se të gjitha veprimet në fushën e energjetikës janë marrë në harmoni me strategjinë energjetike, të miratuar në Kuvend si dhe me direktivat evropiane. Duke folur për angazhimet e ministrisë lidhur me implementimin e këtij ligji, Beqaj tha se ministria ka nxjerrë urdhëresat administrative të parapara për këtë vit. Për angazhimet e së ardhmes, ai njoftoi se Ministria e Zhvillimit Ekonomik është e fokusuar në përgatitjet për organizimin e Konferencës Ndërkombëtare të Donatorëve për Energjinë Alternative dhe Ripërtëritëse. Kjo Konferencë, sipas ministrit Beqaj, pritet të mbahet në pjesën e parë të vitit të ardhshëm. Duke folur për sektorët, ku ligji për eficiencën e energjisë gjen zbatim më të madh, Beqaj tha se prin sektori publik, i cili edhe duhet të jetë shembull për implementim të ligjit, ndërsa vështirësi më të mëdha hasen në sektorin privat. Për të realizuar rezultate më të mëdha në implementimin e Ligjit për eficiencën e energjisë, ministri Beqaj njoftoi se Ministria është duke hartuar planin e një fushate vetëdijesuese për eficiencën e energjisë në Kosovë.

Kryetari – Theksoi se grupi i punës, ka pas disa aktivitete dhe takime me përfaqësuesit e institucioneve, që kanë të bëjnë me zbatimin e Ligjit për eficiencën e energjisë. Pastaj, fjalën ia dha kryesuesit të grupit të punës, z.Visar Ymeri, për të paraqitur aktivitetet, që ka zhvilluar grupi i punës.

Visar Ymeri - Tha se grupi i punës, gjatë mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për eficiencën e energjisë, ka pas dy takime; një me kryeshefin e Agjencisë së Eficiencës së Energjisë - AKEE, drejtorin e Departamentit të Energjisë dhe Minierave, në kuadër të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, dhe, takimin tjetër me përfaqësuesen e Zyrës së BE- së në Kosovë. Po ashtu, ka realizuar dy vizita; një në Shkollën Filllore “Shkolla e Gjelbër” në Prishtinë dhe në komunën e Shtimes. Gjatë këtyre takimeve dhe vizitave, në jemi informuar më për së afërmi, se në cilat pengesa dhe probleme po hasin gjatë zbatimit të Ligjit. Pastaj, ai, ia parashtrroi disa pyetje ministrit Beqaj, si vijon: “Neni 4: Pse kemi pasur vonesë prej dy muajsh në themelimin e AKEE-së? Cilat janë politikat që ka zhvilluar Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe sa është marrë për bazë Strategjia për Energji, në hartimin e politikave në fushën e energjisë? Me cilët mekanizma Ministria e bën zhvillimin dhe mbarëvajtjen e procesit të auditimit në këtë periudhë? Nëse po, cilat janë pikat që mbështeten në këtë strategji? Neni 6: Cilat politika janë propozuar deri më tani nga AKEE-ja në ministri për promovimin e eficiencës së energjisë dhe a janë aprovuar ato nga ministria? Cilat janë arsyet për mos nxjerrjen e aktit nënligjor për përgatitjen e planave

komunale për eficiencën e energjisë? Sa propozime nga AKEE-ja janë dërguar në Ministri, në përputhje me ndryshimet në legjislacionin e BE-së, në fushën e eficiencës së energjisë? Cilat prej ndryshimeve të propozuara, janë miratuar në Qeveri? Nëse nuk ka pasur propozime, cilat janë arsyet që Agjencia nuk ka propozuar ndryshime të tilla? Neni 7: Me cilët mekanizma, Ministria e bën zhvillimin dhe mbarëvajtjen e procesit të auditimit në këtë periudhë? Neni 8: Kur është hartuar raporti për zbatimin e Planit të Kosovës për Eficiencë të Energjisë? Në cilat të dhëna është bazuar hartimi i raportit? Cili ka qenë vlerësimi i Ministrisë për një raport të tillë? Kur është dërguar një raport i tillë në Sekretariatit të Komunitetit të Energji dhe cili ka qenë vlerësimi i tyre për raportin? Nëse nuk është hartuar raporti, cilat janë arsyet që nuk është hartuar një raport i tillë? Neni 10: Cilat akte nënligjore janë nxjerrë për të përmbushur këtë pikë dhe kur janë miratuar? Cilat institucione janë obliguar me këtë akt dhe a ka pasur raportim të tyre pranë AKEE-së? Nëse nuk janë hartuar aktet nënligjore, cilat janë arsyet për mos hartimin e akteve të tilla? Neni 11: Cilat projekte nga Plani i Veprimit për eficiencë të energjisë janë financuar nga buxheti i Kosovës deri më tani? Sa është shuma që Ministria i ka kërkuar në buxhetin e vitit 2013, për financimin e eficiencës? A është kërkuar mbështetje financiare nga organizatat ndërkombëtare për implementimin e masave të përcaktuara në Planin e Kosovës për Eficiencë të Energjisë? Nëse po: Me cilët mekanizma ndërkombëtarë ka bashkëpunuar Ministria, në fushën e eficiencës? Nëse jo, cilat janë arsyet që nuk është bërë një gjë e tillë? Për cilat projekte është kërkuar mbështetje? Në cilat marrëveshje ndërshtetërore, Ministria ka arritur të përfshijë financimin e projekteve në fushën e eficiencës? Në sa marrëveshje është propozuar financimi i tillë? Nëse nuk është bërë, cilat janë arsyet që Ministria nuk ka arritur një marrëveshje të tillë? Sa kërkesa i ka bërë Ministria për bashkëfinancimin e planeve të eficiencës së energjisë? Cilat janë arsyet që në buxhetin e vitit 2013, nuk ka linjë buxhetore për bashkëfinancime të projekteve të eficiencës? Neni 12: Sa akte nënligjorë i ka propozuar Ministria, Qeverisë për auditimin e energjisë në përputhje me direktivat e BE-së, dhe cilat janë ato? Cilat janë kriteret, të cilat ndiqen për auditimin e eficiencës? Neni 13: Sa akte juridike janë paraqitur për miratim në Qeveri, për zbatimin e dispozitave të direktivave të BE-së, lidhur me eficiencën e energjisë? Sa korrespondenca dhe takime ka zhvilluar Ministria me Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, për të u informuar zyrtarisht mbi ndryshimet në legjislacionin e BE-së? Neni 15: Pse nuk janë miratuar të gjitha aktet nënligjore të parapara me ligj, në periudhën prej gjashtë (6) muajsh? Cilat janë arsyet për një vonesë të tillë? Cilat vendime të Këshillit ministror kanë ndikuar në përcaktimin e afateve për përgatitjen e akteve nënligjore?

Besim Beqaj, ministër i zhvillimit ekonomik - Fillimisht tha që shumica këtyre pyetjeve që u parashtruan janë shumë të detajuara dhe nuk ka mundësi për të t'u përgjigjur tani për tani, por ai kërkoi që këto pyetje të dërgohen në përmes postës elektronike ose me shkrim, në Agjencinë për Eficiencën e Energjisë, që është në kuadër të MZHE-së dhe shtoi se këtu është për t'u përgjigjur për anën politike. Pastaj, përgjigjeve të detajuara dhe adekuate, ju kthehen me shkrim. Duke u përgjigjur në pyetjen: pse është vonuar themelimi i Agjencisë Kosovare për Eficiencë të Energjisë, ministri Beqaj tha: "vonesa prej dy muajve për themelimin e kësaj agjencie, ka qenë procedurale", ndërsa në vijim njoftoi se kjo agjenci menjëherë pas themelimit të saj, ka bërë planin e veprimit, në harmoni me strategjinë energjetike.

Lutfi Zharku - Pyeti: a është raportuar nga MZHE-ja në Qeveri, për planin e eficiencës së energjisë? Dhe, a ka në plan MZHE-ja që për eficiencën e energjisë, në të ardhmen të nxitë masa stimuluese shtesë, për sektorin privat, që është shpenzues shumë më i madh sesa sektori publik?

Besim Beqaj, ministër i zhvillimit ekonomik - Duke u përgjigjur në pyetjen, sa i përket sektorit privat për mundësinë e masave stimuluese, tha se është shumë e vështirë të realizohen subvencione në këtë sektorë, në mungesë të buxhetit, sepse duhet të këtë buxhet të dedikuar për këtë fushë, dhe në këtë drejtim, për t'u ndarë buxhet për stimulim për sektorin privat duhet të ndryshohet edhe Ligji mbi Menaxhimin e Financave.

Kryetari – Kërkoi që stafi mbështetës, në bashkëpunim me grupin e punës, t'i hartojnë rekomandimet, duke u bazuar në gjetjet faktikë gjatë mbikëqyrjes së Ligjit për eficiencën e energjisë.

Në fund të këtij takimi, kryesuesi i grupit të punës, për mbikëqyrjen e këtij ligji, Visar Ymeri, tha se pas takimit me ministrin, grupi i punës do të bëjë një raport të detajuar të cilin do t'ia paraqesë Komisionit.

Pas debatit, Komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

Grupi i punës për mbledhjen e radhës të hartojë Raportin me Rekomandime dhe t'ia paraqesë Komisionit për shqyrtim.

3. Të ndryshme **Çështje vijuese.**

Mbledhja përfundoi në orën 14:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Zenun Pajaziti

Kryetar i Komisionit